



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:222884
Datë: 06.06.2022
Numri i dokumentit: 03098295

K.nr.997/21

Gjykata Themelore Gjilan,- Divizioni i Kundervajtjes: sipas gjyqtarit Menderes Behluli dhe zyrtarës ligjore Erzë Mustafa duke vendosur në lëndën kundërvajtjes kundër të pandehurit A.K nga Gjilani, për shkak të veprës kundërvajtse të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **53 par.2**, lidhur me nenin 255 paragrafi 2, të LRRTRR nr 05/L-088, e në bazë të nenit 55 pika 1 dhe 2, 77, 86, 87, 119 dhe 48 p.2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datën **06.06.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit A. K, nga babai O..., i lindur me ..., në Gjilan rr.”...” nr.11, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse me datën **16.09.2021**, aty rreth orës **20:30** min, me automjetin e llojit “**JAGUAR X-Type**” me targa ..., ka shkaktuar aksident komunikacioni në atë mënyrë që duke lëvizur në aksin rrugor Ferizaj-Gjilan, me të arritur mes fshatrave Budrikë-Partesh, duke mos i’ a përshtatur shpejtësinë automjetit të tij kushteve të rrugës, me kthesa, asfalt i lagur, sipas deklaratës për shkaqe teknike të automjetit, humb kontrollin mbi drejtimin e lëvizjes, ku fillimisht del jashtë rrugës nga ana e majtë, përplasat në hendek dheu, kthehet në rrugë dhe përfundon i rrokullisur,

- Si pasojë shkaktohet vetaksident trafiku me lëndime trupore.
- Me ç’veprim ka kryer veprën kundërvajtse të paraparë dhe të sanksionuar me dispozitat e nenit **53 par.2** lidhur me nenin 255 p.2 të LRRTRR nr. 05/L-088, të Kuvendit të Kosovës, andaj

D Ë N O H E T

ME DËNIM-GJOBË në shumë prej 100 (njëqind) euro, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej **15** ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në të kundërtën dënimi do të ekzekutohet me dhunë në kuptim të nenit 163.4 të LK-së.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore, t'i paguaj kësaj Gjykate shumën prej **5 €**, në afat të njëjtë sikurse gjobën.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.
Nga një kopje e aktgjykimi t'iu dorezohet palëve në procedurë .

A r s y e t i m

Trafiku Rajonal në Gjilan, - ka parashtruar kërkesën me nr. **2021-CR-...** me datën **16.09.2021**, për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të lartëshenuar për veprën kundërvajtëse të parashikuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të ndeshkohet sipas ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme.

Gjyqtari me qëllim të vertetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ftoi të pandehurin më ftesë, për datën **16.03.2022** për të dhënë mbrojtjen e tij, i cili edhe pse ftesën me rregull e ka pranuar mos ardhjen nuk e ka arsyetuar andaj gjyqtari për të njëjtin vendosi pa e marr në pyetje konform nenit 48 par.2, pasi që vepra kundërvajtëse bindshëm vërtetohet nga shkresat e lëndës, procesverbali i vendit të ngjarjes nga policët e rastit, fotot e vendit të aksidentit dhe nga deklaratat e dhena ne polici prandaj për të njëjtin vendosi në mungesë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari pas shiqimit të shkresave të lëndës, deklaratave të dhëna në polici dhe fotove mbi vendin e ngjarjes së aksidentit, shkresave tjera në lëndë, me kujdes bëri shtjellimin e të gjitha provave të ofruara në lëndë dhe erdhi në përfundim të plotë, se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet dhe provat e mjaftueshme se i pandehuri është përgjegjës për veprën kundërvajtëse e cila i vehet në barrë, vepër kjo e paraparë dhe e sanksionuar me dispozitat e nenit **53 par.2** lidhur me nein 255 par. 2 të LRRTRR, kështu që të pandehurin e dënoi me denim gjobe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë matjes së dënimit, gjyqtari pati parasysh peshën dhe pasojat e veprës kundërvajtëse, rrethanat objektive dhe subjektive në të cilën është kryer kundërvajtja, rrezikshmërinë shoqërore dhe kështu që në vështrim të nenit **31 pika 1 të LMK-së**, mori parasysh të gjitha këto si rrethana lehtësuese dhe renduese, dhe te pandehurin e ndëshkoi me gjobë konform nenit **35 te LMK-se**, duke konsideruar se edhe me një lloj të tillë të dënimit do të arrihet qellimi i dënimit tek i pandehuri që në të ardhmen mos të përsëris kundërvajtje të tilla.

I pandehuri perveq gjobes së shqiptuar obligohet ti paguaj shpenzimet për ekspertizen mjeko-ligjore dhe paushallin gjyqësor si në dizpozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet gjyqësore është marrë në bazë të nenit 59 par 1, të LMK-së.
Nga të cekurat e më sipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykim

Numri i lëndës: 2021:222884
Datë: 06.06.2022
Numri i dokumentit: 03098295

**Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjthshëm
Divizioni i Kundërvajtjes
Me dt.06.06.2022**

Zyrtarja ligjore
Erzë Mustafa

Gjyqtari
Menderes Behluli

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, paraqitësi i kërkesës dhe pala e pandehur mund të paraqesin ankesë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit aktgjykimi dhe ate Gjykatës së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.